



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT**

Nr. _____ Prot.

Dt. 10/09/2021

Procesverbal

Konsultim publik : Qytetar, biznese, anëtar këshilli dhe administrata

Data : 08.09.2021

Ora : 11:00

Vendi: Këshilli Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : 12 meshkuj dhe 8 femra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024*

I mbajtur sot me datë 08.09.2021, në dëgjuesën publike me videoprojekt, organizuar nga Përgjegjësja e Buxhetit znj. Aida Curraj pranë Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe. Znj. Curraj ka shpjeguar qëllimin e dëgjuesës publike rreth Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, konsultim ky bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 68/2014 “Për Financant e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe në Udhëzimin nr 23. Dt. 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pas një prezantimi të shkurtër nëpërmjet videoprojektit, është shpjeguar edhe aksesit në internet i buxhetit interaktiv mundësuar nga projekti “Bashki të Forta”. Përgjegjësja e sektorit ka shpjeguar fasilitetin online nëpërmjet të cilit shpenzimet, të ardhurat dhe investimet të Programit buxhetor afatmesëm mund të aksesohen në kohë reale dhe ku ilustrohen të dhënat për dy vitet paraardhëse dhe tre vitet pasardhëse. Së fundmi, janë parashtruar pyetje, rekomandime ose paqartësi që mund të kenë pasur të ftuarit. Disa nga qytetarët kanë shtruar pyetje të mënyrës së shpërndarjes së të ardhurave të Bashkisë Malësi e Madhe.

Gjithashtu, pjesëmarrësit morën fjalën duke dhënë rekomandimet dhe kërkesat përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet, të cilat janë si vijon:

Fadil Hyja. Kërkojmë që rruga Vorfë-Hysaj të bëhet e kalueshme sepse prodhimet bujqësore nuk i transportojmë dot.

Ervin Smakaj: Rruga e Llazanit nuk ka ndriçim sepse është dëmtuar

Can Lani: Të bëhet rruga Qafëgrade-Lohe e Sipërme

Dorina Hoxhaj: Të bëhet bum ne rrugën Pigza sepse është lagje e banuar dhe nuk ka asnjë kufizues shpejtësie

Peerlat Semaj: Ktosh, furnizimi me ujë, asfalt dhe sistemimi i koshava te plehrave

Rekomandimet e dhëna në kete dëgjese u jane adresuar strukturës përgjegjëse për hartimin e buxhetit në Bashki, Drejtorisë së Financës.

Mbajtësi i procesverbalit

Emri Mbiemri nënshkrimi